



Pranimi / Dorezimi Prilidheni/Prilidheni Received/Debit	04.02.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRAMBK	474/2021		116



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.413/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.413/2020 të datës 14.12.2020 të parashtruar nga [ ] nga Peja, kundër organit të punësimit Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.02.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.413/2020 e datës 14.12.2020 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Anulohet Vendimi me Nr.ref: 228/2020 i datës 17.06.2020 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe Vendimi me Nr.94/2020 i datës 17.08.2020 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.**
- III. Ndryshohet Vendimi me Nr.ref:215/2020 i datës 26.11.2020 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit.**
- IV. Shfuqizohet Vendimi me Nr.ref:222/2020 i datës 07.12.2020 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.**
- V. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që ankuesin nga pika 1 e këtij vendimi ta kthejë në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit Nr. 97/2013 të datës 23.10.2013, dhe t’ia kompensojë 50% të pagës së humbur nga dita e pezullimit deri në pranimin e këtij vendimi.**
- VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

## A r s y e t i m

Komisioni ad hoc për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.254/2020 të datës 23.10.2020, ka nxjerrë Vendimin me Nr.ref:156/2020 të datës 05.11.2020 përmes të cilit ka njoftuar se nuk mund të trajtoje ankesën e ankuesit me numër protokoli 1060 të datës 20.06.2020 pasi që institucioni duhet të veproje sipas nenit 63 të Ligjit për Shërbimin Civil.

Ndërsa me datë 26.11.2020, Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (me tej MPJD) përmes Vendimit Nr.Ref:215/2020, ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet". Bazuar në këtë vendim, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në MPJD, përmes vendimit Nr.ref:222/2020 të datës 07.12.2020 ka transferuar përkohësisht ankuesin nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm në pozitën e Udhëheqësit të Departamentit për Çështje Konsullore.

Kundër Vendimit me Nr.ref: 228/2020 të datës 17.06.2020 për pezullim parandalues, si dhe Vendimit me Nr.94/2020 të datës 17.08.2020 për transferim të përkohshëm, ankuesi me datë 28.08.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokoli 1650 të regjistruar me numër A.nr.254/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa kundër Vendimit me Nr.ref:215/2020 të datës 26.11.2020 të Komisionit Disiplinor, si dhe Vendimit Nr.ref.222/2020 të datës 17.12.2020 për transferim të përkohshëm, ankuesi me datë 14.12.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokoli 3098 të regjistruar me numër A.nr.413/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.12.2020 përmes Vendimit me Nr.5/2020, ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.254/2020 dhe ankesës me numër A.nr.413/2020 në një ankesë të vetme me numër A.nr.413/2020.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryetari i Këshillit, më datë 22.01.2021 ka nxjerrë Vendimin VK.nt.5/2021 për mes të cilit ka vazhduar afatin e vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën A.nr.413/2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.254/2020 të datës 28.08.2020, me numër protokoli 1650/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokoli 1060 të datës 26.06.2020 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në MPJ; Vendimin me numër reference 228/2020 të datës 17.06.2020 për pezullim parandalues me 50% të pagës; Vendimin nr.94 të datës 17.08.2020 për sistemimin e përkohshëm; E-mailin zyrtar të datës 20.10.2020 të Menaxheres së Personelit në MPJ; Akt Emërimit nr.097 të datës 13.12.2012; Akt Emërimit nr.97/2013 të datës 23.10.2013; Akt Emërimit nr.097 të datës 21.07.2016; Vendimin nr.1-2020 të datës 14.10.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për zgjatjen e afatit të vendosjes; Përgjigjen në ankesë me numër protokoli 1794/2020 të datës 17.09.2020 me shkresat e bashkangjitura; Vendimin A.nr.254/2020 të datës 23.10.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 10.11.2020 me numër protokoli 2529/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Ref:156/2020 i datës 05.11.2020 i Komisionit ad hoc për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Ankesën e datës 14.12.2020 me numër protokoli 3098/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili i datës 02.12.2020 nga Zyra e Personelit në MPJ; Vendimin Nr. Ref: 215/2020 i datës 26.11.2020 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin Nr. Ref:222/2020 i datës 07.12.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin me Nr. 5/2020 i datës 24.12.2020 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për bashkimin e ankesave të ankuesit; Vendimin me VK.nr. 5/2020 i datës 26.01.2021 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vazhdimin e afatit për vendosje; Raporti nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë për ankuesin; Raport nga konsulta QKMF Pejë datës 10.06.2020; Vendim i datës 09.11.2020 i Komunës së Pejës; Vendim i datës 07.12.2020 i Komunës së Pejës; Raporti mbi rastin e testimin nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës datë 08.11.2020 dhe 27.11.2020; Qarkor për Përdorimin e Medimeve Elektronike Sociale datës 24.08.2020 dhe 26.09.2018; Ftesë për seancë dëgjimore e datës 22.01.2021 për ankuesin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Ftesë për seancë dëgjimore e datës 27.01.2021 për Aldisa Morina; E-mailin e datës 28.01.2021 nga Aldisa Morina; Procesverbal i seancës dëgjimore i datës 28.01.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se pezullimi parandalues i tij, transferimi i përkohshëm dhe shqiptimi i masës disiplinore janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për pezullimin e tij parandalues me pagesë 50% të pagës sipas Vendimit Nr.Ref:228/2020 të datës 17.06.2020, për shkak të supozimit për shkelje të rënda të detyrave të punës, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, respektivisht nenin 69 i cili ka përcaktuar se "Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 1.2. nëpunësi civil mbahet në arrest në pritje të gjyqimit; 1.3. kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet", Mbi këtë bazë, Kolegji ka konstatuar se nuk ekziston asnjëra nga kushtet ligjore për pezullim parandalues të ankuesit me pagesë 50% të pagës respektivisht se ndaj ankuesit nuk është iniciuar ndonjë procedurë penale, se mbahet në arrest, apo ekziston dëshmi se prania e tij në zyrë pengon hetimet. Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i bazuara.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin e Ankesës bazuar në shkresat e lëndës konstaton se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Ref:228/2020 të datës 17.06.2020, për pezullim të ankuesit me pagesë 50% të pagës, ka vepruar në mungesë të kompetencës dhe autorizimit ligjor për arsye se në rastet e ekzistimit të kushteve ligjore për pezullim parandalues të nëpunësit civil, pezullimi duhet të behet nga Njësia përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit ashtu siç është paraparë me nenin 69 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Andaj, një vendim i nxjerr në mungesë të kompetencës dhe autorizimit ligjor, me zbatimin të gabuar të dispozitave materiale dhe shkelje të dispozitave procedural, konsiderohet si akt administrativ i paligjshëm ashtu siç është përcaktuar me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Përkitazi me pretendimin ankimor lidhur me Vendimin me numër protokolli 94/2020 të datës 17.08.2020 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD për sistemimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm në pozitën e punës "Udhëheqës i Departamentit për Çështje Konsullore", Kolegji për shqyrtimin e ankesës ka gjetur se ky vendim në pjesën hyrëse nuk përmban shënim të shkurtër të lëndës së procedurës i cili do të ndihmonte palës të kuptoj aktin administrativ. Në dispozitiv nuk është saktësuar afati i kohëzgjatjes së sistemit të përkohshëm dhe se vendimi nuk përmban arsyetimin dhe këshillën juridike lidhur me të drejtën e parashtrimit të mjeteve juridike kundër aktit administrativ. Mbi këtë konstatim rrjedhë se Vendimi me numër protokolli 94/2020 i datës 17.08.2020 është në kundërshtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, një vendim i nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ konsiderohet si akt administrativ i paligjshëm ashtu siç është përcaktuar me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i bazuara.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi i Komisionit Disiplinor, me Nr. Ref:215/2020 i datës 26.11.2020, me të cilin ndaj ankuesit është shqiptuar masa disiplinore "*largim nga zyra dhe transferohet në një lokacion dhe pozitë tjetër me detyra të ngjashme dhe i ndalohej gradimin deri në pesë (5) vite*", Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e nenit 67 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 pika 1.2.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, nga dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit Nr. Ref:215/2020 të datës 26.11.2020, nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore të cekura më lartë për faktin se nuk ka përcaktuar saktë periudhën e transferimit dhe mos gradimit të ankuesit. Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i bazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, nga analizimi i vendimit Nr.Ref:215/2020 të datës 26.10.2020 të Komisionit Disiplinor të MPJD, ka gjetur se Komisioni Disiplinor me rastin e shfuqizimit të Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD me numër reference MPJ-ZSP 94/2020 të datës 17.08.2020 dhe masën e pezullimit të paraparë me Vendimin me numër reference 228/2020 të datës 17.06.2020 të Ministres së MPJD, ka tejkalluar autorizimet e përcaktuara me Rregulloren Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 13 i cili ka përcaktuar se: *Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; të vendos në bazë të provave, nëse është kryer shkelja dhe të përcaktojë dënimin që duhet shqiptuar.*

Ndërsa lidhur me shkeljen e ankuesit për publikimin e mendimit të tij në llogarinë e tij privat të mediumit social-Facebook, lidhur me rrënimin e Teatrit Kombëtar të Tiranës, e konstatuar me Vendimin me Nr. Ref:215/2020 të datës 26.11.2020 të Komisionit Disiplinor, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka analizuar Ligjin Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës si dhe Qarkoren për Përdorimin e Medimeve Elektronike Sociale të datës 26.09.2018 të MPJD-së, ka konstatuar se ankuesi ka vepruar në kundërshtim me nenin 32 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm i cili përcakton se: *Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka për detyrë: të mos bëjë deklaratat që bien në kundërshtim me qëndrimin e Republikës së Kosovës në marrëdhënie me shtetet e tjera ose organizatat ndërkombëtare, si dhe pikën 3 të Qarkores për Përdorimin e Medimeve Elektronike Sociale të datës 26.09.2018 ku përcaktohet se: komunikimi privat i punonjësve të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së*

Kosovës përmes platformave elektronike dhe medimeve sociale, pa marr parasysh se a bëhet në formë të shkruar, me komunikim zëri, fotografive ose video incizimeve, mund të ketë implikime dhe pasoja negative në Shërbimin e Jashtëm dhe të dëmtojë interesat dhe reputacionin e Republikës së Kosovës. Çdo deklaratë, prononcim ose "postim" në mediumet sociale, të cilën e bënë një pjesëtar i Shërbimit të Jashtëm, mund të interpretohet nga publiku si qëndrim zyrtar i Ministrisë së Punëve të Jashtme ose të paktën t'i atribuohet Ministrisë si i tillë. Nuk është me rëndësi se çfarë qëllimi ndjek punonjësi i Shërbimit të Jashtëm kur e bë një "postim", por, se si interpretohet dhe perceptohet ku "postim" nga publiku. Kjo vlen edhe për të gjitha rastet kur ndonjë deklaratë, prononcim ose "postim" privat shënohet si "mendim personal", por, ka të bëjë drejtpërdrejtë me çështje që janë në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Shërbimin e Jashtëm ose në përgjithësi me politiken e jashtme të Republikës së Kosovës. Mirëpo bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka vlerësuar se Komisioni Disiplinor nuk ka arrit të argumentoj pasojat e shkaktuara nga veprimin i ankuesit, si dhe duke marrë për bazë faktin se në shkresat e lëndës nuk ka prova se ankuesi ka përsëritur një shkelje të natyrës së tillë, Kolegji vlerëson se shkelja e ankuesit kualifikohet si shkelje e lehtë sipas nenit 5 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe se bazuar në autorizimin ligjor të përcaktuar me nenin 18 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji ndryshon masën disiplinore për ankuesin nga masa "largim nga zyra dhe transferohet në një lokacion dhe pozitë tjerre me detyra të ngjashme dhe i ndalohet gradimin deri në pesë (5) vite", me masën disiplinore "vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion" e paraparë me nenin 67 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, sa i për ketë konstatimit të Komisionit Disiplinor sipas Vendimit me Nr. Ref:215/2020 të datës 26.11.2020 se ankuesi ka kryer shkelje të rëndë të rregullave të Kodit të Etikës, për shkak se i njëjti ka ushtruar presion psikik ndaj nëpunëses Kolegji gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur që të vërtetojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sepse me asnjë prove nuk është argumentuar se është ushtruar një presion i tillë ndaj nëpunëses Ketë konstatim, Kolegji e mbështet edhe në faktin se nëpunësja nuk i është përgjigjur ftesës për pjesëmarrje në seancë dëgjimore në Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe në seancën e organizuar nga Kolegji për shqyrtimin e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë.

Po ashtu ankuesi nëpërmjet e-mailit [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) më datë 27.01.2021 ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se ministria ka iniciuar procedurë disiplinore për shkak të mungesës së paarsyeshme në punës për pesë ditë apo më shumë. Lidhur me këtë pretendim, duke u bazuar në piken 4 të Vendimit Nr.Ref:228/2020 të datës 17.06.2020 për pezullim të ankuesit me 50% të pagës, përmes të cilit ankuesit i ndalohet hyrja në objektet e MPJD-së, deri në përfundim të procedurës disiplinore, Kolegji vlerëson se organi i punësimit nuk ka mundur të iniciojë procedurë tjetër disiplinore deri në vendosjen në mënyrë përfundimtare të kësaj çështje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i MPJD është i obliguar që ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës në pozitën Drejtori i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit Nr.97/2013 të datës 23.10.2013, duke i bërë kompensimin e 50% të pagës se humbur nga dita e pezullimit të tij deri në

pranimin e këtij vendimi si dhe të vendos në dosje personale masën disiplinore "vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil" e shqiptuar sipas këtij vendimit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër A.nr.413/2020

**Aydyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së